

VENDIM
Nr. 100, datë 4.7.2017

MBI MOSFILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “LUÇENTE KONCENSIONARE” SHPK, NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, 41 pika 1, germa “a” dhe pika 2 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”; neneve 35, pikat 1 dhe 2, 38 pika 2 dhe neni 58 ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neneve 4, pika 1, germa “a”; 5, pika 1, germa “a”; 7 dhe 10, pika 2 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2017; bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 4.7.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për mosfillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Luçente Koncensionare” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Luçente Koncensionare” sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Bordi i ERE, me vendimin nr. 186, datë 23.11.2016, është shprehur për mosfillimin e procedurave të licencimit në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të shoqërisë “Luçente Koncensionare” sh.p.k. për shkak të mosplotësimit të dokumentacionit të nevojshëm.

- Me shkresën nr. 61 Prot, datë 23.4.2017, subjekti ka paraqitur kërkesën në ERE për vazhdimin e procedurës në tejkalim të afatit 1-mujor parashikuar në nenin 10, pika 7 e rregullores.

- Me shkresën nr. 334 Prot., datë 8.5.2017, ERE ka njoftuar subjektin për të aplikuar serish për shkak të tejkalimit të afateve brenda të cilave mund të plotësohet dokumentacioni i munguar pas rrëzimit të kërkesës për fillimin e procedurave të miratimit të kërkesës.

- Kërkesa me nr. 84 Prot., datë 17.5.2017, e paraqitur në ERE për vazhdimin e procedurës së licencimit të shoqërisë “Luçente Koncensionare” sh.p.k. është e nënshkruar nga një person i paautorizuar, për të cilin nuk është depozituar prokurë përfaqësimi, personi është i paidentifikuar (i mungojnë gjeneralitetet), nuk disponon vulën e subjektit dhe marrëdhëniet në raport me subjektin janë të papërcaktuara, nuk rezulton të jetë administrator i shoqërisë ose përfaqësues, referuar ekstraktit të QKR-së.

- Kërkesa e paraqitur nuk vjen në pajtim me nenet 35, pikat 1 dhe 2, 38, pika 2 dhe 58 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, si dhe nenit 7, pika 1, pika 2, germa “a” dhe “b” dhe pika 3, germa “a” dhe “b” të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

- Dokumentacioni i paraqitur më poshtë nuk i plotëson kushtet e një aplikimi në përputhje me formën, përmbajtjen, afatet dhe përcaktimet e kësaj rregulloreje në nenin 10 të saj për sa vijon:

- Neni 9, pika 3, germa “c” (dokumente që vërtetojnë aftësinë dhe/ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera etj.) e paplotësuar.

- Neni 9, pika 4.1.1 (të dhëna specifike për HEC) e paplotësuar.

- Neni 9, pika 4.1.2 (të dhëna për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin) e paplotësuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të mos fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Luçente Koncensionare” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti